



**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti i Mjekësisë

Lëndët/Pozitat:

1. Fizikë mjekësore me Biofizikë

Komisioni vlerësues (prej 3 anëtareve):

1. Kryetar Prof. Dr. Meleq Bahitiari
2. Anëtar Prof. Assoc. Dr. Ramadan Sopi
3. Anëtar Prof. Assoc. Dr. Mentor Sopjani

Kandidatët e paraqitur sipas pozitive/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rëndor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitive apo kandidatëve):

Pozita/lëndët: 1. Fizikë mjekësore me Biofizikë

1. Arton Jaka
2. Blerton Krasniqi
3. Rilinda Doi
4. Milazim Zogaj
5. Mendrit Latifi
6. Besnik Saramati
7. Elmedina Shabani
8. Yll Hoxha

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISTU" S.A.
FAKULTETI I MJEKËSISË
PRISHTINË

Pranuar me:	04.09.2024		
Nj. org.	Nome	Shifra	Vlera
	6785		



RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndën përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).

Në bazë të konkursit (thirrjes publike) të Universitetit të Prishtinës (nr. Prot: 2/426, të datës 25.07. 2024), për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjeratave dhe ushtrimeve për vitin akademik 2024/2025, Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08. 2024, ka formuar komisionin vlerësues për pozitën 7 në mënyrë vendimtare. Ref. Nr. 6628 në përmbajtje: Prof. Dr. Meleq Bahujari (Kryetar), Prof. Assoc. Dr. Ramadan Sopi (anëtar), Prof. Assoc. Dr. Mentor Sopjani (anëtar).

Pas shqyrtimit të dokumentacionit elektronik të kandidatëve konkurrentë, komisioni vlerësues i paraqet Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë këtë:

R A P O R T

Për pozitën 7. (Tre bashkëpunëtor për mbajtjen e ushtrimeve (asistent) për lëndën Fizikë mjekësore me Biofizikë kanë konkurruar 8 kandidatë: **PhD. Cand. Arton Jaka, M.sc. Blerton Krasniqi, PhD. Cand. Rilindë Doli, M. Sc. Milazim Zogaj, M.sc. Mendrit Latifi, PhD. Cand. Besnik Saramati, Dr. med. Elmedina Shabani dhe Dr. med. Yll Hoxha.**

- PhD. Cand. Arton Jaka**, i lindur më 30/12/1998, ka mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës / Data e diplomimit: 16.06.2023 dhe fitoi titullin Doktor i Mjekësisë me notë mesatare 9.29. Është PhD kandidat (PhDc) në Programin e Shëndetit Publik (viti i II-të). Ka qenë i angazhuar për dy vite në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë, Fakulteti i Mjekësisë. Ka të publikuara punime shkencore.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

2. **M.sc. Blerton Krasniqi**, i lindur më 27/06/1994 në Prizren, ka mbaruar Fakultetin e Edukimit programin bachelor Kimi – Fizikë në Universitetin e Prizrenit “Ukshin Hoti” – me notë mesatare 9.43. Studimet master i ka mbaruar në Fakultetin e Edukimit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me notë mesatare 9.37.
3. **PhD. Cand. Rilindë Doi**, e lindur më 14/04/1993 në Gjakovë, ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Departamenti i Fizikës, Drejtimi Arsimor, titulli i fituar Bachelor i Fizikës – Arsimor – Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 9.5. Studimet Master i Fizikës i ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Departamenti i Fizikës - Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.94. Për dy vite ka qenë e angazhuar si asistente në Fakultet të Mjekesisë - UP në lëndën Fizikë mjekësore me Biofizikë.
4. **M. Sc. Milazim Zogaj**, i lindur më 11/05/1984 në Bellanice Komuna Malishevë. Ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematike -Natyrore, Departamenti i Fizikës, Drejtimi Inxhinier i fizikës, titulli i fituar Bachelor Inxhinier i Fizikës – Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.58 Studimet Master i Fizikës i ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Departamenti i Fizikës - Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.33. Për 7 vite ka qenë i angazhuar si asistent në Fakultet të Mjekesisë - UP në lëndën Fizikë mjekësore me Biofizikë.
5. **M.sc. Mendrit Latifi**, i lindur më 10/08/1997 në Gjiuan. Dosja e kandidatit është e pa kompletuar. Mungojnë: diploma bachelor si dhe çertifikata e notave, diploma Masterit është e noterizuar – i mungon vendimi i nostrifikimit (është bashkangjitur vetëm aplikimi për nostrifikim) dhe çertifikata e notave në Master.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

6. **PhD. Cand. Besnik Saramati**, i lindur më 15/05/1986 në Prizren. Ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Departamenti i Fizikës, Drejtimi Inxhinier i fizikës, titulli i fituar Bachelor Inxhinier i Fizikës – Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 7.138 Studimet Master i Fizikës i ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore, Departamenti i Fizikës - Universitetin e Prishtinës me notë mesatare 8.54. Është PhD. Kandidat në Universitetin e Sarajevës – Fakulteti i Shkencave Matematike – natyrore. Për 1 vite ka qenë i angazhuar si asistent për mbajtjen e ushtrimeve në lëndën Biofizikë në Kolegjin Rezonaca.
7. **Dr. med. Elmedina Shabani**, e lindur më 18/07/1999 në Antequera Malaga, ka mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Data e diplomimit: 15.06.2023 dhe fitoi titullin Doktor i Mjekësisë me notë mesatare 9.42.
8. **Dr. med. Yll Hoxha**, i lindur më 29/08/1999 në Podujevë, ka mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Data e diplomimit: 20.05.2024 dhe fitoi titullin Doktor i Mjekësisë me notë mesatare 9.34.

Propozim dhe arsyetim

Bazuar në dokumentet e shkarkuara nga sistemi i aplikimit dhe shqyrtimit të tyre, si dhe mbështetur në Statutin e UP-së (neni 154) dhe rregulloren për Bashkëpunëtorët e jashtëm (neni 7 paragrafi 3 dhe 4), komisioni konstaton se: kandidatët Artion Jaka, Elmedina Shabani dhe Yll Hoxha nuk propozohen sepse fusha e studimit të tyre nuk i përket lëmit të Fizikës mjekësore me Biofizikë.

Kandidati Blerton Krasniqi, nuk propozohet edhe pse ka notën mesatare por, fusha e studimit në të dy nivelet është Fakulteti i Edukimit programi dy lëndorë (Kimi – Fizikë) në Bachelor dhe në master është i specializuar si mesimdhënës lëndor – specializimi Fizikë.

Kandidati Mendrit Latifi, nuk propozohet sepse ashtu si u shënua më lartë nuk e ka dosjen e kompletuar.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS



Kandidatët e propozuar:

Kandidatja Rilindë Doli propozohet për angazhim ngase i plotëson kushtet sipas nenit 154 dhe perzgjidhet duke u bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës ,, Hasan Prishtina” neni 7 paragrafi 3 dhe 4, kandidatja gjatë dy viteve të angazhimit i është përmbajtur kushteve të kontratës dhe ka treguar performancë shumë të mirë në mbajtjen e ushtrimeve nga lënda Fizikë Mjekësore me Biofizikë dhe njëherit është PhD cand. në lëminë e Fizikës.

Kandidati Milazim Zogaj propozohet për angazhim ngase i plotëson kushtet sipas nenit 154 dhe perzgjidhet duke u bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës ,, Hasan Prishtina” neni 7 paragrafi 3 dhe 4, kandidati gjatë 7 viteve të angazhimit i është përmbajtur kushteve të kontratës dhe ka treguar performancë shumë të mirë në mbajtjen e ushtrimeve nga lënda Fizikë Mjekësore me Biofizikë

Kandidati Besnik Saramati propozohet për angazhim ngase i plotëson kushtet duke u bazuar në Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës ,, Hasan Prishtina” neni 7 paragrafi 5 sepse notën mesatare në master e ka 8.54. Fusha e studimit është Fizikë në të dy nivelet Bachelor dhe Master. Kandidati gjithashtu është PhD cand. në lëminë e Fizikës. Kandidati gjithashtu është i punësuar në QKUK në Institutin e Onkologjis si Fizikant Mjekësor që do të jetë një ndihmesë shtesë për studentet.

Komisioni:

1. Kryetar Prof. Dr. Meleq Bahitjari _____

2. Anëtar Prof. Assoc. Dr. Ramadan Sopi _____

3. Anëtar Prof. Assoc. Dr. Mentor Sopjani _____
